

Pasqyra e SEKP- Drafti përfundimtar

Prezantim 1: Përshëndetje/mirëdita/mirëmbërëma, emri im është _____ dhe vij nga kompania Ipsos Strategic Puls. Ne po realizojmë një studim të zgjeruar në BE mbi mënyrën sesi ndihen njerëzit në lidhje me punë që bëjnë, dhe kërkoj ndihmën tuaj. Shtëpia juaj është përzgjedhur rastësisht si pjesë e një kampioni përfaqësues të popullsisë shumë etnike në Kosovë. Dëshiroj t'ju pyes në lidhje me pikëpamjen tuaj mbi disa aspekte të profesionit tuaj.

Më lejo t'ju pyes nëse ndonjë nga anëtarët e familjes suaj është minimalisht 15 vjec dhe punon?

[NESE JO] Dhe a ka ndonjë që ju mendoni se ka punuar- edhe së paku për një orë- kundrejt pagesës ose një tjerër lloj shpërblimi javën e shkuar?

[NESE PO] Sa anëtarë të familjes tënde punojnë ose kanë punuar – edhe pse së paku , për një orë kundrejt pagesës ose një tjerër lloj shpërblimi javën e shkuar?

REGJISTRO NUMRIN E PERSONAVE QE PUNOJNE NE RRESHTIN E FUNDIT TE LETRES SE KONTAKTIT

SIGUROHU QE KE LLOGARITUR CDO ANETAR TE FAMILJES QE ESHTË “NE PUNESIM”!

“ JAVA E SHKUAR NENKUPTON TE HENEN E FUNDIT DERI TE DIELEN E FUNDIT DUKE E PERFSHIRE.

PERKUFIZIMI I RESPONDENTEVE TE MUNDSTEM

Persona në punësim janë ata që kanë mbushur 15 vjec që gjatë javës së referencës kanë bërë ndonjë punë kundrejt pagesës ose përfitimit, ose nuk janë duke punuar por kanë një punë nga e cila janë shkëputur përkohësisht. Përfshihen edhe ata që punojnë për familjen.

“Puna” nënkupton cdo lloj pune kundrejt pagesës ose përfitimit gjatë javës së referencës, edhe për së paku një orë. Paga për fshin pagesën në dorë ose “cdo lloj” pagese (pagesë në të mira materiale ose shërbime jo në para), edhe pse pagesa mund të jetë marrë ose jo në javën kur është bërë puna. Gjithashtu llogarit si në punë cdokënd që paguhet për trajnimin e punës që përfshin prodhimin e të mirave materiale ose shërbimeve.

- *Persona të vetëpunësuar me një aktivitet, fermë ose praktikë profesionale konsiderohen të punësuar nëse përmbushet një nga pikat e mëposhtme:*
 - (1) një person punon për aktivitetin e tij privat, praktikën profesionale ose fermë për qëllime fitimi, edhe pse sipërmarrja mund të jetë duke dështuar.
 - (2) një person shpenzon kohë në drejtimin e një aktiviteti, praktike profesionale ose ferme edhe pse nuk realizohet asnjë shitje, nuk jepet asnjë shërbim profesional, ose asgjë nuk po prodhohet aktualisht (për shembull, një fermer që angazhohet në aktivitetet në shërbim të fermës; një peshkatar që riparon anijen dhe rrjeten e tij për punët e nesërme, një person që kujdeset për një kuvend ose seminar).
 - (3) një person është në procesin e ngritjes së një aktiviteti, ferme ose praktike profesionale; që përfshin blerjen ose instalimin e pajisjeve, porositjen e mjeteve në përgatitje për të hapur një aktivitet të ri
- *Punonjësi i shtëpisë i papaguar quhet i punësuar nëse puna kontribuon drejtpërdrejtë në aktivitet, fermë ose praktikë profesionale në është në zotërim ose drejtim të një anëtari të familjes i së njëjtës shtëpi.*
- *Personi i vetëpunësuar: nëse personat e vetëpunësuar nuk punojnë, ata cilësohen si të punësuar vetëm nëse thonë se kanë një aktivitet, fermë ose praktikë profesionale (p.sh. ata kanë makineritë e nevojshme ose reklamojnë shërbimet e tyre).*
- *Personat që punojnë për veten e tyre në fermën e tyre të vogël agrokulturore, që nuk i shesin të gjitha produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vete dhe zakonisht nuk konsiderohen si të punësuar si pas përkufizimit tonë.*

A. NESE <u>ASNJERI</u> NE SHTEPI NUK PUNON,	FALENDERO DHE PERFUNDOJE, SHENO TE DUHUREN (kodin 41) NE LETREN E KONTAKTIT
B. NESE VETEM NJE ANETARI FAMILJES PUNON KU PUNON AI	SHKO TE PASQYRUESI B
C. NESE ESHTË NJE PUNONJES ME SHUME PERVEC PERSONIT ME TE CILIN FOLE	SHKO TE PASQYRUESI C
D. NESE KA ME SHUME TE PUNESUAR NE SHTEPI	SHKO TE PASQYRUESI D

PASQYRUESI B

PREZANTIM 2. Unë jam duke administruar një studim të mandatuar nga Fondacioni Europian për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës dhe Punësimit. Ashtu sic e përmenda, ky është një studim Europian që është realizuar në secilin shtet anëtar të BE dhe vendeve fqinje. Qëllimi është për të eksploruar mënyrën sesi njerëzit ndihen në lidhje me punën dhe sesi puna që bëjnë ndikon në jetën e tyre. Rrezultati do të përdoret për të mbështetur vendimmarrjen në lidhje me përmirësimin e kushteve të punës. Vëzhgimi aktual është faza e pestë, kështu që rezultatet do të tregojnë sesi kanë ndryshuar kushtet e punës në Kosovë dhe në Europë. A keni kohë t'u përgjigjeni pyetjeve të mia tani? Pyetësi zgjat rreth 30-35 minuta për t'u përfunduar.

Përgjigjet e tua do të mbeten anonime, dhe pjesmarrja juaj është vullnetare. Në cdo stad, ju mund të refuzoni t'i përgjigjeni një pyetjeje ose ta përfundoni intervistën tërësisht.

Fondacioni Europian është një agjensi publike e krijuar nga Bashkimi Europian me qendër në Dublin (Irlandë) e specializuar në kërkimin mbi kushtet e jetesës dhe punësimit në Europë.

NESE AI/AJO MERR PJESE, VAZHDO DHE FILLO PYETESORIN E STUDIMIT, NE PERFUNDIM SHENO KODIN E DUHUR NE LETREN E KONTAKTIT (61-63)!

NESE DESHIRON TE CAKTOSH NJE TAKIM, CAKTOJE DHE SHENOJE NE LETREN E KONTAKTIT!

PASQYRUESI C

A është ky person aktualisht në shtëpi?

1 - po

2 - jo -----> FIKSO NJE VIZITE TE DYTE OSE HIQ DORE NGA AJO ADRESE NESE KJO ESHTË VIZITA JOTE E 4-t

NESE ESHTË AKTUALISHT NE SHTEPI, KONTAKTO ME ATE PERSON , PREZANTOHU PERSERI (PREZANTIM 1), PREZANTO QELLIMET KRYESORE TE STUDIMIT DHE PYETE PERSONIN NESE MUND TE MARRE PJESE (PREZANTIM 2.). NESE PERSONI MUND TE MARRE PJESE, PYETE:

A mund të të pyes, a jeni në punë?

[NESE JO]

Në të kundërt, a keni punuar- edhe pse së paku për një orë të vetme- kundrejt pagesës ose ndonjë lloj shpërblimi tjetër javën e shkuar?

NESE PERSONI NUK ESHTË DUKE PUNUAR OSE NUK E PERMBUSH KRITERIN E MOSHES LARGOHU NGA AJO ADRESE DHE KODO (41).

NESE PERSONI NUK ESHTË NE SHTEPI PERPIQU TE CAKTOSH NJE TAKIM KUR AI OSE AJO MUND TE JENE NE SHTEPI DHE SHENO DATEN NE LETREN E KONTAKTIT.

PASQYRUESI D

Mes atyre që janë së paku 15 vjec dhe kanë punuar javën e shkuar/ javën e kaluar nga e Hena ne te Premte, më duhet të intervistoj personin që e festoi ditëlindjen e tij/ saj së fundmi. A ndodhet ky person në shtëpi?

1 - po

2 - jo -----> FIKSO NJE VIZITE TE DYTE OSE HIQ DORE NGA AJO ADRESE NESE KJO ESHTË VIZITA JOTE E 4-t

NESE ESHTË AKTUALISHT NE SHTEPI, KONTAKTO ME ATE PERSON , PREZANTOHU PERSERI (PREZANTIM 1), PREZANTO QELLIMET KRYESORE TE STUDIMIT DHE PYETE PERSONIN NESE MUND TE MARRE PJESE (PREZANTIM 2.). NESE PERSONI MUND TE MARRE PJESE, PYETE:

Më lejoni t'ju pyes, a jeni vetë ju i punësuar?

[NESE JO]

Në të kundërt, a keni punuar- edhe pse së paku për një orë të vetme- kundrejt pagesës ose ndonjë lloj shpërblimi tjetër javën e shkuar?

NESE NUK PUNON, FILLO NGA E PARA PROCEDUREN ME NJE ANETAR TJETER TE FAMILJES QE PUNON QE E KA DITELINDJEN I DYTI NGA FUNDI.

NESE PERSONI NUK ESHTË NE SHTEPI PERPIQU TE CAKTOSH NJE TAKIM KUR AI OSE AJO MUND TE JENE NE SHTEPI DHE SHENO DATEN NE LETREN E KONTAKTIT.